



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

## GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2022:224136  
Datë: 30.08.2024  
Numri i dokumentit: 06105907

**Ac.nr.7808/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, gjyqtari individual Hysni Bardheci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizimin me Energji Elektrike sh.a., me seli në Prishtinë, Bulevardi “Bill Klinton”, nr.5, kundër debitorit A.Xh. nga Mitrovica, rruga “...”, me bazë juridike borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.714/2019 të datës 23.06.2022, me datë 30.08.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizimin me Energji Elektrike sh.a., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.714/2019 i datës 23.06.2022, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.714/2019 të datës 23.06.2022, në pikën I, ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit A.Xh. nga Mitrovica. Në pikën II, ka shfuqizuar pjesërisht urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr.154/2018 të datës 26.02.2018, për periudhën kohore 04.03.2013 e deri me datën 24.12.2016, në shumën prej 6,408.73 euro dhe në pikën III, ka obliguar debitorin A.Xh. nga Mitrovica, që kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike në Prishtinë, në emër të borxhit për energji elektrike të harxhuar për periudhën kohore nga data 01.01.2017 e gjer me datën 31.12.2017, t’ia paguaj shumën prej 2,604.69 euro, me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, të gjitha këto në afat 7 ditor, duke filluar nga pranimi i këtij aktvendimi e gjer në pagesën definitive të detyrimit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa ashtu që të ndryshohet aktvendimi i atakuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim ose të priset aktvendimi i atakuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datë 23.02.2018, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit të verifikuar nga librat e afariste për pagesën e shërbimeve komunale për konsumimin e energjisë elektrike DMI-9032057, lidhur me borxhin në vlerë prej 9,013.42 euro, për periudhën kohore nga data 05.03.2013 e deri me datë 07.01.2018. Përmbaruesi privat, ka lejuar përmbarimin e kërkuar me urdhrin përmbarimor P.nr.154/18 të datës 26.02.2018, kundër këtij urdhri debitori ka ushtruar prapësim me datë 08.03.2018, ndërsa kreditori ka ushtruar përgjigje në prapësim me datë 12.03.2018.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, me aktvendimin PPP.nr.64/2018 të datës 23.07.2018, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kundërshtimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar pjesërisht urdhrin përmbarimor të përmbaruesit privat P.nr.154/2018 të datës 26.02.2018, me arsyetimin së një pjesë e borxhit është parashkruar. Kundër këtij aktvendimi, kreditori ka paraqitur ankesë e cila është aprovuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin Ac.nr.5155/2018 të datës 21.03.2019, duke e kthyer çështjen në procedim të serishëm në gjykatën e shkallës së parë.

Në rivendosje, gjykata e shkallës së parë duke vepruar konform sugjerimeve të gjykatës ankimore, si dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimin dhe përgjigjes në prapësim ka marr aktvendimin e atakuar duke aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit duke shfuqizuar pjesërisht urdhrin për lejimi e përmbarimit për periudhën kohore 04.03.2013 e deri me datën 24.12.2016, në shumën prej 6,408.73 euro, ndërsa e ka obliguar debitorin, që kreditorit, në emër të borxhit për energji elektrike të harxhuar për periudhën kohore nga data 01.01.2017 e gjer me datën 31.12.2017, t'ia paguaj shumën prej 2,604.69 euro, me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, të gjitha këto në afat 7 ditor, duke filluar nga pranimi i këtij aktvendimi e gjer në pagesën definitive të detyrimit.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka konstatuar se janë pjesërisht të bazuara pretendimet e debitorit për parashkrim, për faktin se i tërë borxhi me të cilin ngarkohet debitori për periudhën kohore nga data 04.03.2013 e deri me 24.12.2016 në shumën prej 6,408.73 euro është borxh i parashkruar, konform nenit 360 par.1 të LMD-së, duke konstatuar se edhe pse nga transaksioni

i kreditorit gjatë kësaj periudhe shihet se debitori ka bërë disa pagesa, mirëpo nuk ka dëshmi se pagesa është bërë në emër të borxhit paraprak apo në emër të faturës për muajin vijues. Kurse sa i përket borxhit për periudhën kohore 01.01.2017 e deri me 31.12.2017 gjykata ka gjetur se i njëjti është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim të borxhit të kreditori në raport me debitorin për këtë periudhë kohore referuar nenit 360 par.2 të LMD-së. Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave ligjore nga neni 3, 17, 29 par.1, par. 2 dhe par.3, 69, 71 dhe 73 të LPP-së, lidhur me nenin 360 par.1 dhe par.2, 368, 369 dhe 382 par.1 dhe par.2 të LMD-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe shkeljeve të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e aktvendimit të atakuar.

Duke marr parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarrim, në bazë të dokumentit të besueshëm që me dispozitën e nenit 29, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore nr.04/L-139, ku përcaktohet se: *“përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së janë: ekstraktet e verifikuara nga librat afariste, për pagesa të shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarrim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm siç është ekstrakti i verifikuar nga libri afarist DMI-9032057. Ekstrakti është i përshtatshëm për përmbarrim ngase është i dorëzuar në origjinal, në të është cekur kreditori dhe debitori, objekti dhe lloji andaj, nga kjo rezulton se dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim dhe se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Lidhur me pretendimet ankimore të kreditorit sa i përket ndërprerjes së parashkrimit konform nenit 368 të LMD-së, dhe pagesave të bëra nga ana e debitorit, Gjykata ankimore vlerëson se është pretendim i pabazuar pasi që në bazë të nenit 360 paragrafi 1, pika 1.1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*, ndërsa paragrafi 2 i po këtij neni përcakton se *“afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit, në të cilin arrihen kërkesat për pagesë”*. Ndërsa me nenin 368 par. 1 të LMD-së parashihet se *“Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”*, ndërsa në par. 2 *“Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”*. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka zbatuar dispozitën e lartcekur pasi që kur kemi të bëjmë me shërbimin e energjisë elektrike për nevoja shtëpiake duhet vlerësuar afati një vjeçar i

parashkrimit, pasi që e drejta e realizimit të borxhit për shumën e faturuar për çdo muaj veç e veç parashkruhet në afatin prej 1 viti, ku sipas paragrafit 2 të nenit 260 të LMD-së afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit, në të cilin arrihen kërkesat për pagesë. Andaj duke u bazuar në këtë dispozitë rezulton së për periudhën kohore nga data 04.03.2013, deri me datë 24.12.2016, kërkesa e kreditorit është parashkruar, kjo për faktin se nga data 31.12.2016, kur ka filluar të rrjedhë afati i parashkrimit për faturat që kanë arritur për pagesë gjatë vitit 2016, e deri në paraqitjen e propozimit për përmbaram datë 23.02.2018, ka kaluar me tepër së një vit. Prandaj, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar së prapësimi i debitorit për parashkrim sa i përket faturave që i përkasin kësaj periudhe është i qëndrueshëm dhe në përputhje me dispozitën e nenit 71 par. 1, pika 1.4, të LPP-së, sipas të cilit si shkak i prapësimit është...”*ka skaduar afati kohor brenda të cilit sipas ligjit mund të kërkohet përmbaram*”.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se pagesat e bëra nga ana e debitorit nuk e kanë ndërprerë parashkrimin e borxhit në kuptim të nenit 368 par.1 të LMD-së, meqenëse nga shkresat e lëndës nuk mund të konstatohet se debitori e ka pranuar borxhin apo ka paguar në emër të borxhit këstin e caktuar, kjo duke marrë parasysh faktin së debitori me rastin e pagesës nuk iu ka referuar faturës specifike dhe së në këtë rast nuk dihet se për cilët muaj të shfrytëzimit të energjisë elektrike është bërë kjo pagesë. Andaj, sipas vlerësimit të gjykatës pagesa në shumë paushallë nuk ka për efekt ndërprerjen e parashkrimit kur behet fjalë për obligimet periodike që rrjedhin muaj për muaj, siç kemi të bëjmë me rastin konkret.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.7808/2022, datë 30.08.2024

Gjyqtari  
Hysni Bardheci